

Prof. Dr. Nikolla DHAMO
Rektori i universitetit "Marin Barleti"

lindur më 1950, në Hllomo / Gjirokastrë
i martuar (1974), 2 djem (1975, 1981)

e-mail: rektori@umb.edu.al



Arsimimi:

| | |
|-----------|---|
| 1964-1968 | Gjimnazi "Q. Stafa", Tiranë |
| 1969-1973 | Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Dega Fizikë 5-vjeçare |
| 1979-1984 | Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Dega Kimi Industriale |

Grada, Tituj: 1984 : Grada "Doktor i Shkencave", 1994 : Titulli "Profesor"

Eksperiencia profesionale:

| | |
|-------------------|---|
| 1973 -1998 | Asistent dhe më pas pedagog pranë UT, fakulteti i shkencave natyrore, departamenti i kimisë, seksioni i inxhinjerisë kimike |
| 1998 - 2003 | Ministria e Punëve të Jashtme: Konsull i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë në Selanik - Greqi |
| 2004 – gusht 2005 | Drejtor i Institutit të Mjedisit - Tiranë |
| shtator 2005..... | Rektor i Universitetit "Marin Barleti" - Tiranë |

Eksperiencia kryesore jashtë shtetit:

| | |
|-----------------------------------|---|
| 1990 -1992 1994 1995 - 1996 | Kërkim shkencor pranë Universitetit Teknik të Berlinit (Gjermani) në fushën e dinamikës dhe kinetikës së reaktorëve elektrokimikë - nën kujdesin dhe me mbështetjen e fondacionit shkencor gjerman "Alexander von Humboldt" |
|-----------------------------------|---|

Gjuhë të huaja: Anglisht, Gjermanisht, Greqisht (njohuri shumë të mira në gjuhën e folur dhe të shkruar), Frëngjisht, Italisht, Ruisht (njohuri të mira në gjuhën e shkruar).

Aktiviteti shkencor:

Tre udhëheqje shkencore për mbrojtjen e gradës "Doktor i Shkencave" (1994, 1995, 1997) dhe 24 udhëheqje diplomash.

Aktiviteti botues:

24 artikuj shkencorë (10 në revista të huaja), 15 tekste mësimore, 3 monografi, 4 raporte teknike dhe 12 kumtesa/referate me një volum të përgjithshëm prej 5330 faqe (të botuara 4620), nga të cilat 2890 faqe janë kontribut vetëm i autorit (të botuara 2400).

Të nderuar studentë, prindër dhe kolegë!

Vitet e fundit jemi të gjithë dëshmitarë që kërkesat në tregun e dijeve gjithmonë e më shumë po orientohen për specialistë me formime, kualifikime dhe specializime jo tradicionale.

Kjo kërkesë e tregut dhe e zhvillimit ekonomik e shoqëror shtron përpara universiteteve detyrën të formulojnë strategji të reja, të cilat të përshkijnë, nga njëra anë përpunimin e programeve dhe kurrikulave që ofrojnë formime dhe kualifikime të larmishme dhe nga ana tjetër ngritjen dhe funksionimin pranë universiteteve të shërbimeve të reja ndaj studentëve, në mënyrë që ata të mund të këshillohen dhe të ndihmohen për të ndërtuar plane individuale studimesh që të jenë njëherësh në përputhje me dëshirat e tyre dhe me kërkesat e tregut.

Universiteti jopublik, si një sipërmarrje e llojit privat, është e kuptueshme se i takon të njihet i pari me mungesat në tregun e dijeve dhe t'u përshtatet me shpejtësi atyre kërkesave.

Nisur pikërisht nga ky objektiv dhe i orientuar në strategjinë e tij nga parimet dhe kërkesat e Deklaratës së Bolonjës, universiteti "Marin Barleti" ofron për studentët jo vetëm një larmi diplomash dhe profilizimesh shumë të kërkuara por edhe një sërë shërbimesh të panjohura deri sot në universitetet tona, duke filluar që nga financimi i studimeve dhe këshillimi i karrierës dhe deri tek nxitja, mbështetja dhe organizimi i një jete studentore aktive... dhe të gjitha këto të sanksionuara në Statutin dhe Rregulloren e universitetit!!

Nikolla Dhamo, Prof. Dr.
Rektori i Universitetit

